



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

PLANI STRATEGJIK PËR BARAZINË GJINORE

PËR MINISTRINË E BRENDSHME PËR VITIN 2025 - 2026

Fjalë përshëndetëse

Barazia gjinore është një parim themelor i shoqërisë demokratike, i sanksionuar në ligj por shpesh i sfiduar në praktikë. Ministria e Brendshme e Shqipërisë luan një rol kyç në promovimin e këtij parimi, duke synuar të përmbushë vlerat e barazisë, integritetit, transparencës dhe gjithë përfshirjes në qeverisje, siguri dhe shërbim publik.

Megjithëse nuk ka një strategji të pavarur për barazinë gjinore, Ministria e Brendshme është pjesë integrale e përpjekjeve kombëtare në këtë drejtim. Ajo bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo strategji angazhon një gamë të gjerë institucionesh, duke përfshirë ato të rendit dhe sigurisë, për të luftuar diskriminimin gjinor dhe dhunën me bazë gjinore.

Policia e Shtetit dhe strukturat e tjera të Ministrisë së Brendshme janë të angazhuara në zbatimin e masave specifike të kësaj strategjie. Këto përfshijnë zhvillimin e trajnimeve për ndërgjegjësimin gjinor dhe implementimin e politikave që promovojnë shanset e barabarta në sektorin e sigurisë.

Plani për Barazinë Gjinore (GEP) i Ministrisë së Brendshme është një instrument i rëndësishëm që synon integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e funksionimit institucional. Ky plan adreson çështje si struktura organizative, menaxhimi i burimeve njerëzore, praktikat e rendit dhe sigurisë publike, si dhe rritjen e përfqësimit të grave në pozita drejtuese. Plani jo vetëm që përputhet me kërkesat e Komisionit Evropian, por gjithashtu adreson nevojat specifike të ministrisë.

Ministria e Brendshme është e angazhuar të zbatojë Ligjin Nr. 9970, datë 24.07.2008 "*Për Barazinë Gjinore në Shoqëri*". Ky ligj ofron kornizën ligjore për eliminimin e diskriminimit gjinor dhe promovimin e barazisë në të gjitha sferat e jetës publike. Ministria punon për të siguruar që parimet e këtij ligji të reflektohen në politikat e saj të brendshme, në proceset e rekrutimit, zhvillimit profesional dhe vendimmarrjes.

Përmes këtyre përpjekjeve, Ministria e Brendshme synon të kontribuojë në krijimin e një shoqërie ku barazia gjinore nuk është thjesht një aspiratë, por një realitet i prekshëm. Kjo përfshin fuqizimin e grave për të marrë role drejtuese dhe kultivimin e një kulture barazie në të gjithë strukturat e saj dhe më gjerë në shoqëri. Duke e bërë këtë, ministria jo vetëm që përmbush detyrimet e saj ligjore, por edhe kontribuon në stabilitetin dhe përparimin e shoqërisë shqiptare në tërësi.

Ministri i Brendshëm
Ervin Hoxha

HYRJE

Plani Strategjik për Barazinë Gjinore (PBGJ) për Ministrinë e Brendshme (MB) është një dokument politikash që mbulon periudhën 2025-2026, i cili reflekton angazhimin e plotë institucional për barazi dhe drejtësi gjinore nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në të gjitha strukturat e MB, nëpërmjet luftës ndaj të gjitha paragjykimeve me bazë gjinore, pakësimit të pabarazive në mjedisin e punë, në procedurat e rekrutimit apo ngritjes në karrierë si dhe përforcimin e një kulture organizative për mundësi të barabarta për të gjithë.

Plani për Barazinë Gjinore për vitin 2025 me objektivat specifike dhe veprimet e propozuara, mbështetet në objektivat e programit të Qeverisë së Shqipërisë për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, kuadrin ligjor kombëtar, si dhe detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara në këtë fushë, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurimit të përputhshmërisë me politikat e Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të integritetit.

Ministria e Brendshme ka hartuar për herë të parë këtë Plan për Barazinë Gjinore, megjithëse angazhimi institucional ka nisur më herët me caktimin e një koordinatori për barazi gjinore në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*”. Policia e Shtetit realizon detyrimet që lindin nga Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021 – 2030 si dhe zbaton Planin Kombëtar të Veprimit të kësaj Strategjie. Në kuadër të punës së saj, Policia e Shtetit ka miratuar një Procedurë Standarde për Parandalimin e Ngacmimit Seksual në vendin e punës, të miratuar me Urdhrin Nr.96 datë 07.2020. Policia e Shtetit ka miratuar dokumentin e “*Manualit të Etikës Policore*” me Urdhër nr. 980 datë 30.06.2023 për përdorim nga punonjësit e Policisë së Shtetit në të cilin parashikohet barazia gjinore, mos diskriminimi dhe integriteti. Në vijim janë organizuar disa aktivitete trajnuese me qëllim njohjen dhe zbatimin e dokumentit të politikave dhe procedurave kundër ngacmimit, me punonjës policie të Drejtorive Vendore të Policisë dhe Drejtorive Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, me pjesëmarrje të të gjitha niveleve të gradave dhe punonjës civil.

Përgjatë viteve të fundit, në raportin e performancës së Ministrisë së Brendshme janë përfshirë edhe tregues me bazë gjinore.

Ministria e Brendshme administron dhe menaxhon fondet publike, sipas pesë programeve buxhetore të miratuara, konkretisht:

- 1) Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”;
- 2) Programi “Policia e Shtetit”;
- 3) Programi “Garda e Republikës”;
- 4) Programi “Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara”;
- 5) Programi “Shërbimi i Gjendjes Civile”.

Ndër objektivat specifike për realizimin e këtyre programeve janë përfshirë edhe objektiva të matshme në lidhje me buxhetimin e përgjithshëm gjinor veçanërisht në programin e Policisë së Shtetit dhe në programin e Gardës së Republikës.

Për programin “Policia e Shtetit” në respektim dhe promovim të plotë të barazisë gjinore, janë përcaktuar tregues konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm si “Numri i punonjësve të policisë rrugore gra ndaj totalit”, “Numri i punonjësve të FNSH gra ndaj totalit”, “Shtetase të huaja gra të trajtuar në qendrën e pritjes në Karec”, “Staf gra në PKK”, “Numër policesh femra të diplomuara ndaj totalit të arsimuar”, “Rekrut gra ndaj totalit të rekruteve”, “Numër i grave/totalit në strukturat e Policisë së Shtetit”, “Raporti i efektiveve policore gra në pozicione drejtuese/totalit të drejtueseve”, “Bashkëshorte të trajtuara në zbatim të VKM nr.256, datë 25.03.2015 *“Për kompensimin e privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe shërbimit”*. Në programin e Gardës së Republikës një tregues i matshëm ka qenë “% e grave gardistë ndaj totalit”.

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

E drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që prej Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18), në të cilën përmendet shprehimisht se: “1. *Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*; 2. *Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*; 3. *Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlikje e arsyeshme dhe objektive*.”. Kjo e drejtë është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentesh ndërkombëtarë, të cilat janë ratifikuar nga parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

Kuadri ndërkombëtar

Kuadri ndërkombëtar mbi të cilin është ndërtuar ky plan përfshin:

- ✓ Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality).
- ✓ Konventën për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAë).
- ✓ Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BDPfA).
- ✓ Konventën e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- ✓ Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ, 2030)
- ✓ Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.
- ✓ Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë”.

Në mënyrë më konkrete, ky plan është ideuar në përputhje dhe respektim të Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm të OKB-së. OZHQ nr. 5 *“Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave”* përcakton standarde të rëndësishme në kuadër të miratimit dhe zbatimit të politikave që promovojnë barazinë gjinore dhe synojnë fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha etapat e punës dhe karrierës së tyre.

PSBGJ është në përputhje me Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “*Për gruan, paqen dhe sigurinë*”. Rezoluta vë theksin tek rëndësia e rolit dhe pjesëmarrjes së barabartë të grave në procesin e parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme, dhe vë në plan të parë një agjendë për gratë, paqen e sigurinë në botë. Republika e Shqipërisë iu bashkua vendeve që kanë hartuar një Plan Veprimi në kuadër të detyrimeve të zbatimit të Rezolutës në vitin 2018 përmes miratimit të Planit të parë të Veprimit për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Masat e parashikuar në këtë rezolutë janë në përputhje me Planin e Veprimit të NATO-s 2021-2027 për agjendën GPS, i cili mbështet angazhimin e aleatëve për të mbështetur barazinë gjinore dhe integrimin e perspektivave gjinore në angazhimet e NATO-s. Edhe pse të dhënat flasin në tërësi për një rritje të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në forcat ushtarake, policore, apo edhe në sektorë të tjerë, numri i grave dhe vajzave në drejtim në sektorët e ruajtjes së sigurisë dhe paqes ende mbetet i ulët.

PSBGJ është gjithashtu në përputhje me politikën e Bashkimit Evropian (BE) që mbështet veprimet e shoqërive dhe qeverive për të angazhuar, fuqizuar, mbrojtur dhe mbështetur gratë dhe vajzat me prejardhje të ndryshme. Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025 përcakton objektivat dhe veprimet e politikave për të bërë përparim të rëndësishëm deri në vitin 2025 drejt një Evrope të barabartë në aspektin gjinor. Qëllimi është që gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, të jenë të lirë të ndjekin rrugën e tyre të zgjedhur në jetë, të kenë mundësi të barabarta dhe mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në shoqërinë tonë evropiane. Objektivat kryesore janë t'i jepet fund dhunës me bazë gjinore dhe stereotipeve gjinore, të adresohen barrierat gjinore në tregun e punës, në pjesëmarrjen në sektorë të ndryshëm të ekonomisë si dhe arritja e ekuilibrit gjinor në vendimmarrje dhe në politikë.

Kuadri kombëtar

Plani Strategjik i Barazisë Gjinore bazohet në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.6.2021. Kjo strategji përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individët, gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht karakteristikave individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre.

Akte ligjore në mbështetje të Planit të Barazisë Gjinore:

- ✓ Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*”. Ky ligj parashikon ndalimin e pabarazisë me bazë gjinore në çdo fushë, sigurimin e integritetit gjinor në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, mbledhjen e detyrueshme të të dhënave gjinore si dhe edukimin e barazisë gjinore.
- ✓ Ligj nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, i cili parashikoi me ndryshimet e vitit 2016 konceptin e buxhetimit të përgjithshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor

- ✓ Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” që gjithashtu ka përfshirë këtë qasje,46 si dhe VKM Nr. 465 datë 16.07.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, e cila parashikon planifikim të objektivave të matshme gjinore në programet buxhetore të institucioneve qendrore.
- ✓ Ligj nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar i cili përfshin respektimin e barazisë gjinore duke vendosur edhe kuota në organet e zgjedhura në nivel qendror e vendor, përfshirë edhe kuotën për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30 % të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të njësive bazë të qeverisjes vendore.
- ✓ Ligji Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Institucionet përgjegjëse

Referuar mekanizmit kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, Koordinatorët e Barazisë Gjinore (KBGJ) janë përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Metodologjia

Metodologjia për hartimin e PSBGJ 2025-2026 u zhvillua përmes hapave në vijim:

1. *Analiza e kontekstit dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues.*
Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues apo draft dokumentesh të Ministrisë së Brendshme, referuar dhe kuadrit ligjor si dhe politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.
2. *Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t’u përfshirë në PBGJ 2025-2026*
Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan nga identifikimi i prioritetëve të realizuar në fazën e parë, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e Ministrisë së Brendshme.
3. *Përgatitja e draft dokumentit të PBGJ 2025-2026*
Drafti i përgatitur për konsultim përmbante kuadrin ligjor dhe fushat e ndërhyrjes, objektivat specifike dhe masat e veprimet e parashikuara për arritjen e objektivave specifike. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakordësuara në konsultimet paraprake brenda institucionit.
4. *Miratimi i PBGJ 2025-2026*
Versioni përfundimtar i PBGJ u përcoll për miratim te Ministri i Brendshëm dhe do të publikohet edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme.

Fushat e ndërhyrjes dhe objektivat specifike

Fushat prioritare për ndërhyrje paraqiten si në vijim:

- ✓ Angazhimi institucional për barazi gjinore nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në të gjitha strukturat e Ministrisë së Brendshme si dhe nëpërmjet luftës ndaj të gjitha paragjyqimeve me bazë gjinore. Ndërgjegjësim dhe rritje e kapaciteteve për agjendën Gruaja Paqja Siguria.
- ✓ Balanca gjinore në drejtim dhe vendimmarrje, rekrutim dhe progresi në karrierë;
- ✓ Përfshirja e ekuilibrit punë-jetë në kulturën organizative të institucionit;
- ✓ Parandalimi i dhunës me bazë gjinore duke përfshirë ngacmimin seksual në vendin e punës;

Plani i detajuar i masave pjesë e PSBGJ 2025-2026

	Masat e planifikuara sipas fushave
I. Fusha prioritare: Angazhimi institucional për barazi gjinore nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në të gjitha strukturat e Ministrisë së Brendshme si dhe nëpërmjet luftës ndaj të gjitha paragjyqimeve me bazë gjinore. Ndërgjegjësim dhe rritje e kapaciteteve për agjendën Gruaja Paqja Siguria.	
Objektivi: Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve për të njohur dhe luftuar paragjykimet gjinore të pavetëdijshme për stafin dhe drejtuesit në Ministrinë e Brendshme. Njohja e mëtejshme dhe përforsimi i ekspertizës për agjendën GPS.	
1.	Masa 1.1 Sigurimi dhe monitorimi i të dhënave me ndjeshmëri gjinore për stafin e MB në të gjitha nivelet.
	Veprimi 1.1.1 Ndërgjegjësimi i stafit përgjegjës në lidhje me rëndësinë e të dhënave me ndjeshmëri gjinore.
	Veprimi 1.1.2 Hartimi i një manuali/rregulloreje në lidhje me llojin dhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave me ndjeshmëri gjinore në MB.
	Veprimi 1.1.3 Ngritja e kapaciteteve të stafit që do të merret me mbledhjen e të dhënave me ndjeshmëri gjinore nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm.
2.	Masa 1.2 Monitorimi i buxhetit të përgjithshëm gjinor nëpërmjet monitorimit të performancës së treguesve të caktuar me ndjeshmëri gjinore.
	Veprimi 1.2.1 Analizë e trendit të performancës së treguesve me ndjeshmëri gjinore bazuar në raportet mbi monitorimin e shpenzimeve të MB për tre vitet e fundit 2022-2024.
	Veprimi 1.2.2 Shtimi dhe analiza e treguesve me ndjeshmëri gjinore edhe në programet e tjera buxhetore si programi “Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara”, Programi “Shërbimi i Gjendjes Civile”.
3.	Masa 1.3 Rritja e vizibilitetit të angazhimit të MB për politika të barazisë gjinore përmes promovimit të iniciativave, stimujve dhe praktikave të mira duke zbatuar një program të

	angazhimit për barazi.
	Veprimi 1.3.1 Përfshirja e vazhdueshme e stafit në seminare ose trajnime në lidhje me çështje të barazisë gjinore.
	Veprimi 1.3.2 Evidentimi i praktikave më të mira në faqen zyrtare të MB
4.	Masa 1.4: Forcimi i kapaciteteve të administratës për agjendën GPS
	Veprimi 1.4.1 Përmirësimi i përshkrimit të punës për pozicionin e koordinatorit të barazisë gjinore duke patur parasysh agjendën GPS.
	Veprimi 1.4.1 Zhvillimi i trajnimeve për konceptin dhe agjendën kombëtare “Gruaja Paqja Siguria” për punonjësit e MB të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 në vend.
	Masat e planifikuara sipas fushave
II. Fusha prioritare: Balanca gjinore në drejtim dhe vendimmarrje, rekrutim dhe progresi në karrierë.	
Objektivi: Fuqizimi dhe rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në strukturat drejtuese dhe në proceset vendimmarrëse duke forcuar rolin dhe lidhësin e grave në të gjithë sektorët e MB.	
1.	Masa 2.1 Përfshirja e treguesve me ndjeshmëri gjinore që kanë të bëjnë me progresin e grave dhe vajzave në karrierë.
	Veprimi 2.1.1 Përfshirja e treguesve me ndjeshmëri gjinore “ Përqindja e grave Drejtues të Mesëm (Drejtor Drejtorie).
	Veprimi 2.2.2 Përfshirja e treguesve me ndjeshmëri gjinore “ Përqindja e grave Drejtues të Lartë (TND).
2	Masa 2.2 Promovimi i përfaqësimit të barabartë në këshilla vendimmarrëse dhe borde drejtuese
	Veprimi 2.2.1 Ndërgjegjësimi mbi balancën gjinore në vendimmarrje me anë të tryezave të rrumbullakëta dhe seminareve të ndryshme të organizuara nga organizata të shoqërisë civile të specializuara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave si dhe ekspertë të barazisë gjinore në vend.
	Veprimi 2.2.2 Promovimi i rasteve të suksesit të progresit në karrierë të grave dhe vajzave në MB.
	Veprimi 2.2.3 Kryerja e një studimi të detajuar në lidhje me barrierat e progresit në karrierë për gratë dhe vajzat në të gjithë sektorët e MB si dhe diskutimi dhe promovimi i rezultateve të këtij studimi.
	Masat e planifikuara sipas fushave

III. Fusha prioritare: Përfshirja e ekuilibrit punë-jetë në kulturën organizative të institucionit.	
Objektivi: Rritje e angazhimit institucional për promovimin e një balance të shëndetshme pune-jetë si dhe përforcimi i një kulture organizative për mundësi të barabarta.	
1	Masa 3.1 Ndërgjegjësim dhe mbështetje institucionale për një ekuilibër punë-jetë.
	Veprimi 3.1.1 Ndërgjegjësimi për nevojën për një balance të shëndetshme pune-jetë nëpërmjet seminareve të vazhdueshme për stafin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.
	Veprimi 3.1.2 Përfshirja e elementëve që kanë të bëjnë me fleksibilitetin në orarin e punës për prindërit me fëmijë të vegjël në rregulloret për mjedisin e punës.
	Masat e planifikuara sipas fushave
IV Fusha prioritare: Parandalimi i dhunës me bazë gjinore duke përfshirë ngacmimin seksual në vendin e punës.	
Objektivi Parandalimi i dhunës me bazë gjinore duke përfshirë ngacmimin seksual në vendin e punës.	
	Masa 4.1 Ndërgjegjësimi dhe rritja e kapaciteteve në lidhje me parandalimin e dhunës me bazë gjinore duke përfshirë ngacmimin seksual në vendin e punës.
	Veprimi 4.1.1 Hartimi i një rregulloreje që përfshin procedura mbrojnë stafin e MB nga të gjitha format e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual.
	Veprimi 4.1.2 Rritja e ndërgjegjësimit për rregulloren dhe procedurat e miratuara kundër çdo forme të dhunës.
	Veprimi 4.1.3 Trajnim për stafin e gjinisë femërore se si të dallojnë dhe reagojnë ndaj gjuhës dhe qëndrimit me orientim seksual.

**Plani i detajuar i masave pjesë e PSBGJ 2025-2026, shoqërohet me identifikimin e strukturave përgjegjëse për realizimin e tij dhe afatet kohore përkatëse për efekt monitorimi të zbatimit të tij.*